

## 10 ÇËSHTJE MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE NË FACEBOOK<sup>1</sup>

### 1. Abuzime ose raportime mbi përmbytjen

Të përdoret nëse dikush ankohet për sjellje abuzive në Facebook. Lidhjet e mëposhtme shpjegojnë politikën tonë, se si ne e trajtojmë përmbytjen abuzive dhe se si të raportohet ajo.

*Lidhje të dobishme për përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/communitystandards>

<https://www.facebook.com/report>

*Lidhje të dobishme për jo përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/help/noaccount>

### 2. Mashtruesit

Të përdoret nëse dikush ankohet në lidhje me një llogari/profil në Facebook i cili shtret sikur të jetë ai. Lidhjet e mëposhtme shpjegojnë se si bëhet raportimi.

*Lidhje e dobishme për përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/help/reportingimpostors>

*Lidhje e dobishme për jo përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/help/noaccounts>

### 3. Ngacmimet

Përdoruesit e Facebook të cilët ndihen se janë vënë në shënjestër apo i ngacmojnë në Facebook, mund ta bllokojnë apo ta raportojnë këtë sjellje.

*Lidhje e dobishme për përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/help/harassment>

*Lidhje e dobishme për jo përdoruesit e Facebook*

<https://www.facebook.com/help/noaccounts>

### 4. Pamje të paautorizuara

(E drejta e Privatësisë së Pamjeve)

Facebook i ofron përdoruesit mënyra për të raportuar fotografi ose video për të cilat ata mendojnë se është një shkelje e të drejtës për privatësi. Ky kanal raportimi është në përdorim si për përdoruesit e Facebook si për jo përdoruesit

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/imageprivacyrights>

### 5. Kërkesa për Qasje

Facebook ofron një mjet vetë-shërbimi për t'i dhënë përdoruesve mundësinë e qasjes në të dhënat personale që Facebook mban rreth tyre.

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/accessyourdata>

### 6. Të fshish një llogari Facebook

Çaktivizimi vs Fshirje

Përdoruesit e Facebook kanë mundësi të çaktivizojnë ose fshijnë llogarinë e tyre. Dallimet në mes dy opsioneve janë përshkruar në Qendrën e Ndihmës të Facebook.

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/deactivate-delete>

### 7. Të dhënat që dalin jashtë Facebook

(psh në kërkimet e Google)

Facebook nuk kontrollon përmbytjen e indeksuar dhe te ruajtur në motorët e kërkimit. Më shumë informacion mund të gjeni në Qendrën e Ndihmës të Facebook

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/searchengines>

### 8. Politika e emrit të vërtetë

Facebook është një komunitet ku njerëzit përdorin identitetet e tyre të vërteta. Të gjithëve iu kërkohet të japin emrat e tyre të vërtetë, kështu që përdoruesi gjithmonë e di se kush janë ata me të cilët lidhet. Kjo është e përfshirë në Deklaratën e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Facebook me të cilën përdoruesit pajtohen, për të krijuar një llogari në Facebook.

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/realname>

### 9. Përdoruesit që ndërrojnë jetë dhe përkujtimi

Kur një përdorues i Facebook ndërron jetë, llogaria e tij mund të përkujtohet në mënyrë që të mbrohet privatësia e tij. Kur një profil përkujtohet, Facebook vazhdon të nderojë parametrat e privatësisë dhe të vërë në zbatim karakteristika të sigurisë për të mbrojtur llogarinë.

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/memorialization>

### 10. Jo përdoruesit të cilët marrin email nga Facebook

Përdoruesit e Facebook kanë mundësi të ngarkojnë kontaktet e tyre nga kontaktet e tyre në e-mail, dhe të dërgojnë një ftesë nëpërmjet email tek këto kontakte duke i ftuar ata që të bashkohen në Facebook. Nëse një jo-përdorues ka marrë email nga Facebook, kjo është ndoshta për shkak se miqtë e tij ose persona të tjerë të cilët e njohin i kanë dërguar ftesë për t'iu bashkuar faqes. Në mënyrë që të ndalin marrjen e ftesave nëpërmjet email-it, Facebook i fton jo përdoruesit që të ndjekin udhëzimet në pjesën e poshtme të email-it. Megjithatë, në qoftë se ata duan të ndalojnë marrjen e emaileve, Facebook ka nevojë të mbajë një regjistrim të adresës së email-it në mënyrë që ta shtoj në listën e "mos dërgimit të email-it".

*Lidhje e dobishme*

<https://www.facebook.com/help/invitationemails>

<sup>1</sup> Ky informacion është përgatitur nga Facebook Ireland Data Protection Authority Casework Team dhe është shpërndarë në Konferencën e 35-të Ndërkombëtare të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Varshavë, Poloni. Përkthimi në shqip është realizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale